

Majlinda Nana Rama
MBI VËLLIMIN POETIK “BESA”

POEZIA E BESIM XHELILIT, REFLEKSIVE DHE DISKRETE

Të zbulosh *undergroundin* e shpirtit njerëzor, është një dëshirë, sa tunduese, aq edhe sfiduese për një poet. Në fakt, përshtypja e arritjes në këtë tribunë, merr formë sapo shfleton librin më të fundit të autorit Besim Xhelili. Ajo që bie në sy, së pari, është fakti që nuk i ka mbetur në tentativë kjo rrekje e gjithëhershme poetësh, dhe së dyti, shquhet, i theksuar, vargu i spikatur nga një individualitet krijues, çka e bën këtë vëllim këndshëm të lexueshëm.

Xhelili është kujdesur të shfletojë deri në thellësi, botën e brendshme të njeriut, si qenie jo thjesht ekzistenciale, por si qenie me një galeri të pafund ndjenjash, dëshirash, dashurish, provokimesh, joshjesh, humbjesh, pritjesh, distancash...

Të gjithë këtë pështjellim ndjenjash e përjetimesh që bashkëshoqërojnë çdo ditën njeriun, autori e sjell bukur në poezinë “Lëmsh jete”. Shohim me çfarë shpërthimi emocional performon në këtë poezi:

*“Shumë të pakuptueshme ditët...
s’duroj dot këtë mëshirë që më brengos
e më dhemb të shoh si lahes në lot vetmie netëve,
mos i digj ato buzë, me mallin mos u bëj rob,
ëndrrave hapu rrugën...”*

Malli dhe vetmia janë dy gjendje që rrëmbejnë si shpendë grabitqare. Ato duket se janë bërë trendi i kohëve ku jetojmë, kohë të rraskapitura nga largësitë. Duket se ngushëllimin protagonist i poezisë e gjen tek ato shkronja të akullta distancash, që lotët i bëjnë edhe më të pakuptimta ndonjëherë.

*“Natën ta lexosh kur je vetëm tek liqeni, aty në breg
derisa bebëzat e syve të tu mes yjeve kërkojnë diçka,
atë që të djeg në gjoks dhe për të cilën je e etur.
prej syve të tu buron një e fshehtë - dashuri...”*

Mirëpo, autori sërish gjen një shteg brenda vetes, sepse është diku një buzëqeshje që zbardhë, vetëm për t'ia çelur ditën si mëngjeset...dhe Ai...i dorëzohet tërësisht fatit...

*“Zëri yt shumëngjyrësh më sjell gëzime...
te gusha jote më përplasi fati...”*

E për të mbetur tek e bukura, autori gjezdis fund e krye hapësirës femër. A ka ndonjë mendje njerëzore që arrin të kundërshtojë botën në *“sytë e saj”*? Poeti e paraqet këtë glob në sy grash, si një hapësirë të përbotshme që të *“zë në grackë”*:

*“Sytë e saj shkëlqejnë nga gëzimi...
më ngjallin hare e çaste të lumtura,
unë s’gjej veten dëshirave të humbura.
...mes ëndrrash natën duke pritur”.*

Shiu, rrugët, deti, vjeshta, mugullira e vesa e mëngjesit, vijnë si fllad në poezinë e Xhelilit. Është bukur të ravijëzosh pamje panoramike të këtilla, por tepër e vështirë të mbahet një kënd i ekuilibruar mes ndjenjës, dashurisë, vuajtjes. Poeti arrin të paraqesë me forcë çdo ndjesi të heroit lirik, ndërsa sjell paralele elementësh, kur dashurinë e sheh si universalitet që nuk kërkon këmbë urash, por hapësira lisho’...që ngjisin - magnet...

Shohim poezinë *“Urë ndjenjash”*:

*“S’desha urë ndjenjash mes nesh të krijohet
siç lidhen më afër dy anët e malit,
kur shpirti me shpirtin njëherë bashkohet...”*

Ndërkohë, edhe në poezinë *“Besa”* (titull dhe ide që ia ka besuar edhe gjithë librit), autori sjell botën me ngjyra dhe botën bardhë e zi, njëherësh. Ai mbërthen çastin e rrëmetin në jetën e gjallë, duke e paraqitur atë, me të gjithë fuqinë e pushtetit që jep. Zëri i brendshëm e çon shpirtin peshë, duke mos gjetur prehje...

“...Shpesh shpirti më shtegton vend e pa vend...”

Kjo poezi edhe pse merr tek-tuk nuancat e një poezie vetjake, kapërcen tej kësaj, duke prekur një çështje mbarënjerëzore, atë që thamë më lart, largësive që mbajnë e ndajnë zemra, mes dhimbjesh, sakrificash, mes sprovës së madhe të besës, si në legjenda. Kjo është një poezi emblematike që nuk vargëzon, por trajnon, apo udhëheq deri në vetëdije.

“...Është e mundshme mallin ta bëjmë çast lumturie...”

Ajo që humbet, ajo që tretet në largësi, shtrohet si një tezë moralizuese, deri diku, dhe, në fund, autori i jep përgjigje vetë, gjithë parantezës mungesore, të krijuar me herët në poezi:

“...Unë e ti do të hapërojmë bashkërisht kohës përtej...”

Poezia e Besimit, është poezia që i reziston kohës, jo vetëm sepse është e mbrujtur me copëza jetësore, por sepse vargu i tij socializohet paqshëm me aktualitetet brenda dhe jashtë shpirtërore.

Përsa i përket figuracionit, poeti i ka qëmtuar kujdesshëm ato, ndërsa në secilin varg, ka mbretëruar me metaforën e përkorë. Kjo vihet re në poezi, si: “Takim i papritur”, “Sot as retë, as natyra nuk dhurojnë aromë”, “Arrati”, “Ditë të bardha”, “Mbi qiej të largët”, “Mëdyshje”, “Iluzion”, “Poemth emocionesh”, “Sonte nuk jam si atëherë”, “Oqean kënaqësish”, etj.

Poezitë e këtij libri kanë stil, kanë shpirt, kanë diapazon krijues e reflektojnë, dukshëm dhe padukshëm, në labirintet e së përditshmes sonë të përbashkët mbarëglobale dhe të qenësishme sa vetë jeta.